

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Objekti i këtij Studimi është evidentimi i shfaqjes dhe evoluimit të strukturave të krimit të organizuar gjatë periudhës 1990-2015, nëpërmjet kuptimit më të mirë të tipologjisë së organizimeve kriminale shqiptare, që prej shfaqjes së tyre në fillimet e viteve 1990 e deri në vitin 2015. Nga ana tjetër, ky studim ka si qëllim të nxjerrë në pah shkallën e sofistikimit të krimit të organizuar dhe situatën aktuale të tij në disa qytete kryesore të vendit. Studimi identifikon dhe analizon gjithashtu disa faktorë ekonomik dhe social të cilët ekspozojnë shoqërinë shqiptare ndaj krimit të organizuar.

Ky Studim vjen si një domosdoshmëri e cila ndihmon studimet e kësaj fushe nga njëra anë, por nga ana tjetër shërben edhe si një platformë analitike për të informuar politikën kundër krimit të organizuar shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky Studim ofrohet gjithashtu në një moment kritik për “tranzicionin” që po kalon shteti i së drejtës në Shqipëri, siç është miratimi i paketës kushtetuese të Reformës në Drejtësi² dhe nevoja për aprovimin e rreth 41 ligjeve të tjera në mbështetje të reformës.³ Disa prej ligjeve me interes të miratuara deri në dhjetor 2016 përfshijnë: Ligji “Për legjitimitetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”⁴ i cili hedh bazat për formimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe të Njësisë së Pavarur Hetimore; si dhe Ligji “Për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁵ Njëkohësisht, rëndësi të veçantë paraqet formimi i strukturave speciale të hetimit të krimit sic është “Byroja Kombëtare e Hetimit”.⁶

Për të kuptuar rrethanat në të cilat u shfaqën format e para të krimit të organizuar në vend, janë analizuar një sërë faktorësh shoqërorë, politikë dhe ekonomikë të pranishëm pas ndryshimit të sistemit politik. Faktorë si të ardhurat e ulëta për frymë (më pak se 20 dollarë në muaj për kokë në 1992), tkurrja me rreth tre herë e ndërmarrjeve aktive (nga 6607 të tilla para 1993 në 2759 në 1997), dobësia e institucioneve shtetërore përballë lulëzimit të veprimtarive të paligjshme (koeficienti mesatar i veprave penale për periudhën 1994-2014 llogaritet 170,7)⁷, lejimi dhe shembja e firmave piramidale (1.5 miliard dollarë të investuara në total) dhe hapja e depove të armatimit (550 mijë armë në qarkullim të lirë) shkaktuan valë masive emigrimi (tkurrje me 10 për qind e popullsisë së përgjithshme nga 1994-20014), kaos, ndjenja të pasigurisë së jetës, ndërtimin e strukturave paralele të shtetit (‘komitetet e shpëtimit’), korrupsion, kriminalitet dhe lulëzim të strukturave të organizuara kriminale. Nga ky terren i favorshëm kriminal përfituan individë me precedentë penal dhe banda të armatosura, të cilat vepruan në një marrëdhënie komplekse me politikën dhe biznesin.

Ky studim pasi nxjerr në dritë forma të krimit të organizuar qysh në regjimin komunist, siç ishte rasti i njësisë speciale “101K” për kontrabandimin e cigareve, shpjegon se si ish agjentë të Sigurimit, ushtarakë, policë, shoferë të cilët kishin patur mundësinë të lëviznin jashtë vendit si dhe sportistë të dikurshëm shfrytëzuan përgatitjen, njohuritë dhe lidhjet e tyre me diasporën për të përfituar nga veprimtari të paligjshme si kontrabanda dhe trafikimi. Pjesë e kanaleve të paligjshme u bënë dhe segmente shtetërore dhe politike, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe tërthortë. Përgjatë tranzicionit politik, organizimet kriminale kanë shfaqur tipare të ndryshme në përshtatje të zhvillimeve të kohës duke shkuar gradualisht drejt sofistikimit.

2. Projekt Amendamentet kushtetuese kanë kaluar me ligjin nr. 76/2016, dt 22.07.2016.

3. Shiko të paketën e plotë të ligjeve të planifikuara sipas reformës në në eëbsitin zyrtar të Komisionit të Posacëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Aksesuar në <http://www.reformanedrejttesi.al/baza-ligjore>

4. Ligji nr. 138/2015 “Për legjitimitetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

5. Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”. Ligji nr 84/2016 “Për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

6. Ligji “ Për Policinë e Shtetit”, nr. 108/2014 i ndryshuar në vitin 2016.

7. Koeficienti i kriminalitetit është një parametër që mat kriminalitetin në një mjedis të caktuar në raport me popullsinë e atij mjedisi, pra tregon shkallën e konsumimit të veprave penale (krimeve ose kundërvajtjeve), duke e vendosur këtë të dhënë përballë numrit të personave. Si rregull ai shpreh numrin e krimeve për 100.000 banorë. Llogaritje të autorit bazuar në të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë (Vjetarët Statistikorë 2004-2014) për numrin e krimeve dhe të veprave penale, dhe në të dhënat e INSTAT për popullsinë (e cila është llogaritur bazuar në projeksionet e popullsisë nga të dhënat e censusit 2011)

Për shkak të tipareve të veçanta të evoluimit të strukturave kriminale ndër vite, studimi është ndarë në dy periudha kohore (1990-2003 dhe 2004-2015), duke ofruar njëkohësisht një lehtësi në të kuptuarin e karakteristikave të tyre. Strukturat më të rrezikshme kriminale që kanë vepruar në Shqipëri deri në vitin 2003 janë marrë në shqyrtim me qëllim për të kuptuar natyrën, si dhe faktorët që kanë lejuar dhe nxitur shfaqjen dhe lulëzimin e tyre. Analizimi i një sërë vendimesh gjyqësore kundër drejtuesve dhe pjesëtarëve të këtyre strukturave kriminale ka mundësuar ofrimin e një tabloje të përbërë nga karakteristika si njohjet dhe lidhjet midis tyre, niveli i armatimit dhe dhunës së përdorur, ndërveprimi me agjencitë ligjzbatuese, prokurorinë dhe gjykatat, si dhe veçori të tjera. Pohimet e ekspertëve të intervistuar dhe burime të shkruara dëshmojnë për më tepër, lidhje të tyre me parti politike dhe politikanë të caktuar në vend, gjatë periudhës së analizuar. Anësia partiake dhe ndërveprimi me politikën paraqitet te disa prej bandave të armatosura që kanë vepruar në rajone si Tirana, Durrësi, Elbasani, Vlora, Korça, Berati, Fieri, Lushnja, dhe Tropoja.

Rreth vitit 2003, format e hershme të krimit të organizuar në vend filluan të evoluojnë dhe përshtaten ndaj ripërtëritjes së institucioneve, forcimit të hetimeve, ndjekjes penale dhe goditjes ndaj tyre. Kryesisht pas vitit 2005, strukturat e dikurshme të bandave të armatosura apo organizatave kriminale u zëvendësuan gradualisht me rrjete kriminale të përbëra nga grupe autonome, mjaft efikase dhe fluide, me role dhe përgjegjësi në segmente të caktuara të veprimtarive të paligjshme kriminale.

Analiza e Riskut (2004-2015)

Duke filluar nga viti 2003, strukturat e organizuara kriminale në vend filluan të sofistikohen në përgjigje të forcimit gradual të institucioneve shtetërore. Disa tregues të sofistikimit janë diversifikimi i veprimtarive të paligjshme në të cilat ata përfshihen, përshtatja e trajtave horizontale në formën e rrjeteve kriminale, përdorimi gjithmonë e më tepër i një gjuhe të koduar, përdorimi i numrave celularë të posaçëm të cilët aktivizohen vetëm për kryerjen e trafikeve si dhe përdorimi i korrierëve të ndryshëm.

Më vonë, nga viti 2008 e më pas vihet re se grupet shqiptare forcuan ndjeshëm pozitat e tyre në rrjetet ndërkombëtare të trafikut, sidomos atë të narkotikëve. Shihet se në rrjetet e trafikimit përfshihen role që nuk konstatoheshin përpara vitit 2003, siç është rasti i garantuesit apo dhe financuesit.

Një tjetër karakteristikë që shfaqet është përdorimi nga krimi i organizuar i bizneseve të ligjshme si një “*fasadë*” mbrojtëse për të fshehur dhe maskuar trafikimin e kokainës dhe drogave të tjera.

Në periudhën 2005-2015 një ndër format më të përhapura të trafikut të kanabisit ka qenë transporti me peshkarexhë deri në det të hapur. Sasi të konsiderueshme kanabisi janë transportuar gjithashtu përmes rrugëve ajrore, ku raste të ndryshme të përdorimit të avionëve të lehtë sportivë janë dokumentuar edhe në media.

Një tendencë tjetër që shkon drejt sofistikimit është kalimi nga faza kur grupet kriminale godasin institucionet shtetërore në fazën kur ato krijojnë lidhje të forta me segmente shtetërore duke ndikuar qoftë në politikën lokale, por dhe atë qendrore.

Një aspekt tjetër evident i sofistikimit të organizatave kriminale është integrimi i të ardhurave kriminale në biznese të ligjshme dhe përfshirja e tyre në politikë-bërje. Financimi i zgjedhjeve nga të ardhura prej veprimtarive të paligjshme apo të dyshimta meriton vëmendjen serioze të aktorëve politikë, institucioneve ligjzbatuese dhe shoqërisë shqiptare.



Harta e Grupeve Kriminale (2015)

Ky studim pasqyron gjithashtu një panoramë të situatës aktuale kriminale (viti 2015) duke evidentuar organizimet kriminale më problematike në qytetet kryesore të vendit. Studimi nxjerr në pah se thuajse në të gjitha qytetet kryesore të vendit ka grupe të strukturuar kriminale të cilat kanë kontroll territori dhe të cilat janë fokusuar kryesisht në trafikun e narkotikëve, gjobëvënien dhe mbledhjen e borxheve.

Sipas gjetjeve të mbështetura në intervistat me ekspertë dhe njohës të krimit të organizuar në nivel lokal, Studimi bën një përshkrim të disa prej organizatave kriminale më të fuqishme që veprojnë aktualisht në disa nga qytetet kryesore të vendit.

Tiranë

Në qytetin e Tiranës aktualisht mendohet të veprojnë të paktën 3 organizata kriminale shumë të fuqishme të strukturuar të cilat kanë një shtrirje kohore të aktivitetit kriminal të hershëm dhe të cilat kanë arritur ti rezistojnë kohës për shkak të sofistikimit dhe lidhjeve të tyre me biznesin dhe segmente të korruptuara të shtetit. Organizata e parë diskutohet ti ketë fillimet që në vitin 1994 dhe objekti kryesor i aktivitetit të saj është pastrimi i të ardhurave kriminale të mafies ndërkombetare. Organizata e dytë dyshohet të ketë të paktën 27 anëtarë dhe ka si objekt kryesor trafikun e narkotikëve, gjobëvënien dhe mbledhjen e gjobave për të tretët. Organizata e tretë hamendësohet të jetë më pak në numër dhe më pak aktive por me investime të rëndësishme në fushën e minerareve.

Shkodër

Dyshohet që në qytetin e Shkodrës të veprojnë të paktën 4 “familje”⁸ të mëdha të cilat janë përfshirë në aktivitete kriminale. Të 4 “familjet” janë të përfshira kryesisht në trafikun e narkotikëve, armëve dhe qenieve njerëzore. Nga ekspertët hamendësohet se Shkodra mund të jetë “hambari” i ardhshëm i rritjes së kanabisit dhe ky ndryshim për pasojë, mund të sjelli forcimin e metëjshëm të këtyre organizatave kriminale. Ky fuqizim mund të rrezikojë rëndë stabilitetin e kësaj zone duke pasur parasysh ekuilibrat e brishta sociale në këtë rreth.

Durrës

Në qytetin e Durrësit diskutohet që të kenë investime shumë grupe kriminale të cilët vijnë nga i gjithë vendi, dhe ky qytet shërben deri diku edhe si pikë takimi apo edhe strehimi për shumë prej tyre. Mendohet që në Durrës aktualisht të jetë ri-aktivizuar një organizatë kriminale e cila drejtohet nga individë më precedentë të mëparshëm penal. Hamendësohet gjithashtu se në qytetin e Durrësit prej kohësh vepron një “familje” e njohur në botën e krimit dhe me influencë jo vetëm në aktivitete tregtare por dhe aktivitete sociale.

Vlorë

Karakteristikë e grupeve kriminale të qytetit të Vlorës është se në dallim nga grupet të cilat ishin aktive në vitin 92-99 (*Zani Caushi, Kakami, Gaxhai etj*), nuk ka më territore të ndara. Vihet re që vrasjet në qytetin e Vlorës janë të shumta dhe këto vrasje në përgjithësi nuk janë për çështje territori por për zonat e influencës në rrejetet ndërkombëtarë të narkotikëve dhe armëve në vëndet e BE kryesisht në Spanjë dhe Itali.

Fier

Organizatave kriminale që veprojnë në qytetin e Fierit sipas shumicës së të intervistuarve, mendohen të jenë ndër organizatat më të sofistikuar dhe më të qëndrueshme në të gjithë historinë e tranzicionit politik në Shqipëri. Hamendësohet se grupet kriminale në Fier, në ndryshim nga qytetet e tjera bazohen jo vetëm në lidhje gjaku dhe shoqërore por mbi të gjitha në lidhje komunitare (*psh. komuniteti kosovar dhe cam*). Mendohet se kohëve të fundit eksponentë të lartë të krimit të organizuar me precedente kriminalë dhe të njohur si drejtues organizatash kriminale në vëndet e BE (*Greqi, Itali, Belgjikë dhe Spanjë*) kanë investuar në këtë qytet të ardhurat e tyre kriminale dhe mendohet se po zgjerojnë ndjeshëm influencën e tyre edhe pranë partive politike, sidomos atyre të vogla.

8. Me “familje” të përfshira në krimin e organizuar do të kutpojmë ato grupime kriminale të cilat strukturën drejtuese organizative të tyre e mbështesin në lidhjet familjare sipas hierarkisë së familjes, duke filluar nga kryefamiljari (babai ose vëllai i madh), e ndjekur më pas nga vëllezërit më të vegjël, kushërinjtë dhe duke zbritur tek rrethi shoqëror që kryesisht mbështetet tek komshinjtë

Berat

Qyteti i Beratit mendohet të jetë një qytet ku krimi i organizuar ka investuar për një kohë të gjatë dhe vazhdon të jetë aktiv. Dyshohet se organizatat kriminale në këtë qytet janë kryesisht lokale të mbështetura në lidhje të forta familjare dhe shoqërore. Flitet se në këtë qytet kanë influencë të paktën 3 “familje” me precedentë të fortë kriminalë.

Elbasan

Vrasjet e shkurtit të vitit 2016, treguan se qyteti i Elbasanit vazhdon të mbetet një pikë e nxehtë ku aktiviteti i krimit të organizuar vazhdon të jetë prezent edhe pas shkatërrimit të dy bandave famëkeqe të “Mandelës” dhe “Tan Kateshit”. Një trend i rrezikshëm që po vërehet në këtë qytet është se format organizative të grupeve kriminale në qytet po imitohen nga grupe të rinjsh në zonat rurale përreth. Duke pasur parasysh situatën ekonomike dhe edukimin në rrethina, rrezikohet që të kemi zhvendosje të organizatave kriminale me struktura hierarkike në zonat rurale.

Përmbledhje e Gjetjeve Kryesore

- Studimet mbi krimin e organizuar paraqesin vështirësi në mbledhjen e të dhënave pasi pjesëmarrësit në intervista ngurrojnë të bashkëpunojnë.
- Ka një mungesë të dhënash, studimesh dhe raportesh zyrtare të bëra publike në lidhje me krimin e organizuar në Shqipëri.
- Të ardhurat e ulëta për frymë (nën \$20/muaj për kokë në 1992), reduktimi me tre herë i ndërmarrjeve aktive, trefshimi i nivelit të papunësisë, tkurrja deri me 10% e popullsisë së përgjithshme nga flukset masive të emigracionit, kontrabanda e naftës nga 1992-1996, zhdukja e rreth \$1.5 miliard nga skemat piramidale dhe hapja e depove të armatimit në 1997, nxitën ndjenja të pasigurisë publike dhe favorizuan lulëzimin e veprimtarive të paligjshme, duke përfshirë ato me karakter të organizuar kriminal.

- Në fillim të viteve '90-të, korrupsioni dhe infiltrimi i elementëve të krimit të organizuar në institucionet e dobëta shqiptare siguroi paprekshmërinë e eksponentëve të botës së krimit. Një pjesë e mirë e tyre kishin punuar dikur si agentë të shërbimeve sekrete, punonjës policie, oficerë të Gardës së Republikës, apo edhe shoferë dhe sportistë gjatë regjimit të mëparshëm.
- Krimi i organizuar, biznesi dhe politika janë mpleksur në një marrëdhënie të komplikuar interesash të përbashkëta dhe shfrytëzimi me përfitim të ndërsjellë.
- Organizatat kriminale kanë lidhje me politikën, dhe kjo e fundit ndërhyr duke neutralizuar agjencitë ligjzbatuese nëpërmjet emërimeve të njerëzve të besuar ose militantëve partiak.
- Forma më e njohur e bashkëpunimit midis organizatave kriminale dhe organizmave shtetërore është korrupsioni, sidomos në sistemin e drejtësisë. Dhe ky sipas të intervistuarve nuk është fenomen lokal por i përhapur në të gjitha ato rrethe ku krimi i organizuar është problematik.
- Zhvatja e të ardhurave nga biznesi përmes gjobave apo 'mbrojtjes' nga bandat e tjera, mbështetja e kandidatëve politikë apo frikësimi i kundërshtarëve në zgjedhje, prishja e mitingjeve të partisë kundërshtare, manipulimi i votave dhe financimi i fushatave elektorale në këmbim të imunitetit nga ndjekja penale dhe përfitimeve të tjera janë disa prej nuancave të marrëdhënies së politikës me krimin që është sofistikuar ndër vite. Parti politike kanë përfituar fonde nga drejtues rrjetesh kriminale.
- Ka një trend shqetësues të përdorimit të biznesit si "fasadë" nga organizatat kriminale për të fshehur aktivitetin kriminal. Ky fenomen duket më i përhapur në fushën e trafikut të kokainës.
- Në rajone të ndryshme të vendit, rivaliteti mes bandave të armatosura ndonëse ka patur si motiv kryesor kontrollin e territorit, ka shfaqur shpesh ngjyrimë të anshme politike. Pjesëtarë të grupeve kriminale kanë shërbyer si komisionerë në qendrat e votimit. Pavarësisht mungesës së hetimeve apo vendimeve gjyqësore, deputetë dhe ministra të ndryshëm kanë qenë subjekt i akuzave publike për lidhje me krimin e organizuar.
- Krimi i organizuar ka arritur të neutralizojë shoqërinë deri në lirinë e shprehjes duke çënuar kështu seriozisht kulturën e denoncimit.

-
- Pavarësisht se në vendimet gjyqësore mund të referohen automjete luksoze, prona dhe arsenal armësh të sofistikuara në posedim dhe përdorim të të pandehurve, është shqetësues fakti që hetimet dhe vendimet gjyqësore nuk thellohen tek burimet e këtyre të ardhurave, të cilat nuk mund të justifikohen përmes veprave penale si vrasje dhe plagosje për të cilat janë dënuar kryesisht pjesëtarët e këtyre strukturave kriminale.
 - Në qytetin e Tiranës aktualisht mendohet të veprojnë të paktën 3 organizata kriminale shumë të fuqishme të strukturuar të cilat kanë një shtrirje kohore shumëvjeçare të aktivitetit kriminal.
 - Në qytetin e Shkodrës dyshohet se veprojnë të paktën 4 “familje” të mëdha të cilat janë përfshirë kryesisht në trafikun e narkotikëve, armëve dhe qenieve njerëzore. Ky rreth mund të zëvendësojë “Lazaratin” dhe të kthehet në “hambarin” e ardhshëm të rritjes së kanabisit.
 - Në qytetin e Durrësit diskutohet që të kenë investime shumë grupe kriminale të cilët vijnë nga i gjithë vendi, dhe ky qytet shërben deri diku edhe si pikë takimi apo edhe strehimi për shumë prej tyre.
 - Organizatat kriminale që veprojnë në qytetin e Fierit mendohen të jenë ndër organizatat më të sofistikuara dhe më të qëndrueshme në të gjithë historinë e tranzicionit politik në Shqipëri.
 - Në qytetin e Beratit dyshohet se kanë influencë të paktën 3 “familje” me precedentë të fortë kriminalë.
 - Vrasjet e shumta në qytetin e Vlorës dyshohet se kryen për zonat e influencës në rrjetet ndërkombëtare të narkotikëve dhe armëve në vendet e BE kryesisht në Spanjë dhe Itali.
 - Në Elbasan po vihet re se format organizative të grupeve kriminale në qytet po imitohen nga grupe të rinjsh në zonat rurale përreth.
 - Së fundmi, organizatat kriminale që merren me trafikun e drogave të rënda po përdorin bizneset legjitime për të “maskuar” aktivitetin e tyre kriminal.

Rekomandime

- 1.**Të konsiderohet mundësia e ndërhyrjes në Kodin Penal për prezantimin e një dispozite të re që dënon çdo formë shoqërimi të llojit mafioz (e ngjashme me Art 416 bis të Kodit Penal Italian), pjesëtarët e së cilës përpiqen të përfitojnë nga fuqia intimiduese e lidhjeve të tyre për të siguruar të ardhura dhe përfitime si shuma monetare, kontroll i bizneseve, licencave, koncesioneve, si dhe përmes përfshirjes në sigurimin e votave gjatë proceseve zgjedhore;
- 2.**Reformimi i legjislacionit që ka të bëjë me partitë politike dhe financimin e fushatave zgjedhore dhe partive politike, me qëllim parandalimin e financimit nga burime të krimit të organizuar apo të dyshimta;
- 3.**Ngritja e strukturave të posaçme “anti-mafia” me përbërje të ekspertëve të fushave të ndryshme (juristë, financierë, informaticienë, etj.);
- 4.**Forcimi i hetimit në nivel vendor dhe përfshirja e një prokurori të Krimeve të Rënda në cdo prokurori rrethi;
- 5.**Goditja e formave korruptive dhe infiltrimit nga krimi i organizuar në të gjitha nivelet, nga ato të kryera nga punonjës publikë të nivelit bazë, tek ato menaxherialë, drejtues si dhe politik-bërës;
- 6.**Ndërtimi i bazave të të dhënave në lidhje me veprimtari të krimit të organizuar, dhe intensifikimi i hetimeve dhe rritja e numrit të vendimeve të sekuestrimeve dhe konfiskimeve të aseteve me origjinë kriminale. Menaxhim më efikas dhe efektiv i aseteve të sekuestruara;
- 7.**Ndërhyrje e menjëhershme me politika social-ekonomike lehtësuese dhe favorizuese për zonat më të prekura nga veprimtari të krimit të organizuar, si dhe ato më të largëta dhe vulnerabël;
- 8.**Forcimi i bashkëpunimit agjensi shtetërore-shoqëri civile për rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e krimit të organizuar;
- 9.**Ndërtimi i partneritetit të agjensive shtetërore specializuara me ekspertë dhe organizata të pavarura për kryerjen e studimeve, analizave dhe hartimit të politikave kundër krimit të organizuar të mbështetur mbi evidenca;
- 10.**Ndërtimi, përditësimi dhe konsultimi i rregullt nga prokurorë dhe gjyqtarë i një baze të unifikuar të dhënash lidhur me precedentët penalë të cilët duhet të merren parasysht dhe ndikojnë në masën e dënimit;
- 11.**Të rishikohen rregulloret e brendshme dhe praktikrat ekzistuese jo-transparente në mënyrë që të garantojnë akses sa më të plotë në vendimet dhe dosjet gjyqësore, dhe sidomos kur ato kërkohen për qëllime studimore nga institucionet e arsimit të lartë, shoqëria civile, media dhe specialistët e fushës, duke siguruar anonimizimin e të dhënave për aq sa është ligjërisht e nevojshme;
- 12.**Të rishikohet Kodi Penal, specifikisht nenet 237 dhe 238, ku të përfshihet si vepër penale cdo sulm fizik, psikologjik dhe shantazh ndaj gazetarëve investigativë/shoqërisë civile/studuesve të cilët kryejnë investigime ose raporte/studime në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ky sugjerim mbështetet në faktin se roli i shoqërisë civile dhe medias është rol publik kur lidhet me çështje të cilat i përkasin interesit publik.

Metodologjia

Duhet cilësuar që në krye të herës vështirësitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave për këtë Studim. Nga pikëpamja e eksperiencës studimore, intervistat nxorën në pah se organizatat kriminale sot kanë arritur të krijojnë një situatë frike në komunitet dhe kjo ndikon në dobësimin e kulturës së denoncimit në shoqëri dhe neutralizimin e agjensive ligjzbatuese. Sot ka organizata kriminale të cilat kanë arritur të përfshihen në politikë, biznes media dhe veprimtari sociale dhe edukuese. Shumë prej tyre kontrollojnë territore, kanë investime të konsiderueshme dhe ndikojnë në mënyrë aktive në politikën shqiptare. Kjo bën që segmente të fuqishme të krimit të organizuar të monitorojnë dhe kontrollojnë emërimet dhe si rezultat dhe informacionin. Në këtë kontekst, shumë individë të cilëve ju është kërkuar të intervistohen kanë ngurruar, ose kanë dhënë përgjigje të përgjithshme, ose kanë refuzuar. Disa të tjerë, për t'iu shmangur sa më shumë identifikimit, i kanë nisur përgjigjet e tyre në formë elektronike. Pra, ndikimi i krimit të organizuar ka arritur të neutralizojë shoqërinë deri në lirinë e shprehjes, duke çenuar kështu seriozitetin kulturën e ndëshkueshmërisë. Studimi është mbështetur në metodat cilësore si të vetmet mënyra të mbledhjes së të dhënave të cilat të japin mundësinë e njohjes së thelluara të kontekstit dhe faktorëve të sofistikuar social të cilët nuk mund ti kuptosh dot me metodat sasiore. Sigurisht metodat cilësore kanë vështirësitë e tyre të cilat mund të çenojnë analizën siç është numri i vogël i tyre apo dhe varësia e madhe ndaj të intervistuarit.

Studimi mbështetet në tre burime kryesore:

- 1)** Analizë të 71 vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda për rreth 50 struktura kriminale duke u nisur nga një ndarje gjeografike dhe kohore që do të lejonte për të ndërtuar një analizë sa më të plotë për ecurinë e krimit të organizuar në periudhën 1990-2015. Kështu janë zgjedhur për tu analizuar 25 struktura kriminale që kanë vepruar në periudhën 1990-2003 dhe 25 struktura kriminale që kanë vepruar në periudhën 2004-2014. Duhet të nënvizojmë se për këto periudha kohore Studimi i është referuar kohës kur janë dhënë vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Pra veprimtaria e këtyre strukturave kriminale ka qenë pak më e hershme se koha e dhënies së vendimi (p.sh vendimi për një organizatë është dhënë në vitin 2012 por aktiviteti i saj është shtrirë në periudhën 2007-2009). Sot ka shumë grupime kriminale të cilat janë ende në gjykim dhe të cilat nuk janë përfshirë në këtë raport si p.sh. “Banda e Tritolit” ose e “Vrasësve me Pagesë”.
- 2)** Analizë të rreth 84 intervistave. 44 intervista janë kryer në vitin 2014. Këto janë plotësuar dhe me 40 intervista të posaçme, gjysmë të strukturuar në periudhën 2015-2016 me ekspertë (gjyqtarë, prokurorë, avokatë, ish gjyqtarë, ish oficer policie), gazetarë investigativë, dhe përfaqësues të shoqërisë civile në rrethin e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Korçës, Lushnjës dhe Vlorës.
- 3)** Analizë të 5 rasteve studimore mbi grupe specifike të organizuara mbi organizata kriminale të cilat i përkasin të dy etapave studimore (1990-2005 dhe 2005-2015). Për të kuptuar më mirë kontekstin social dhe dinamikat e kohës këto çështje janë marrë nga 5 zona të ndryshme të vendit Shkodër (Veri); Elbasan (Shqipëri e Mesme); Korçë (Juglindje); Lushnjë dhe Vlorë (Qendër/Jug).